

MUHARREM DEZHGIU

**“DIELLI” NË SHËRBIM TË ÇËSHTJES KOMBËTARE
SHQIPTARE NË VITET E LUFTËS SË DYTË BOTËRORE***

Gjatë gjithë historisë së saj 100-vjeçare (1909-2009) gazeta “Dielli” realizoi një mision historik në shërbim të kombit shqiptar. Mund të thuhet me bindje të plotë se historia e “Diellit” është ajo e Shqipërisë dhe e shqiptarëve. Qysh prej themelimit të shtetit shqiptar “Dielli” ka përjetësuar në faqet e veta fatet e kombit.

Duke luftuar me çdo mjet (me memorandume, me protesta, me shkrime, me të holla) “Dielli” shkëlqeu në mbrojtje të kufijve etnikë të kombit shqiptar. Ai e ngriti zërin kundër rreziqeve që i kërcënoheshin ekzistencës së shqiptarëve si komb e si shtet. “Dielli”, si shprehëse e mendimit dhe e veprimtarisë së “Vatrës”, e lartësoi atë si vatrë të shqiptarizmit.

“Vatra” dhe “Dielli” përbëjnë për shqiptarët një simbolikë të fuqishme. Ata zgjuan tek shqiptarët idenë e zjarrit e të dritës që do nënkuptonte flakë patriotizmi dhe rreze kulture. Një atdhetari, para 40 vjetësh, do t’i pëlqente ta përqaiste “Vatrën” me Kongresin e Manastirit. “Vatra” na mësoi me dashtë Atdhenë, shprehej ai, - Manastiri çeli rrugën e zhvillimit sistematik të letrave (gërmave) tona. Këto dy institute (“Vatra” dhe “Kongresi i Manastirit” – M.D.) na mësoan se kur shqiptari bashkëpunon me shqiptarin, nuk del gjë që t’ua ngatërrojë lafshat, që t’ua pengojë rrugën¹.

Me plot të drejtë “Dielli” është cilësuar si dekani i shtypit shqiptar, sepse, që kur lindi e vazhdimisht, është vënë në shërbim të popullit shqiptar duke predikuar “ungjillin” e kombësisë së tij. Ndaj “Dielli” ka shkëlqyer si diell mesdite, p-a re dhe pa perëndim. I tillë ka qenë “Dielli” në shërbim të çështjes kombëtare edhe në vitet e Luftës së Dytë Botërore. Ky do të jetë dhe objekti i trajtësës sime në këtë konferencë.

*

* * *

Lufta e Dytë Botërore për shqiptarët filloi në prillin e vitit 1939, kur Shqipëria u sulmua nga Italia fashiste. Që nga kjo kohë në faqet e gazetës

* Kumbësë e mbajtur në Konferencën Shkencore të organizuar nga Fedarata Panshqiptare “Vatra”, me rastin e 100-vjetorit të botimit të gazetës “Dielli”, New York, 13 qershor 2009.

¹ Nga fjala e Karl Gurakuqit me rastin e 60-vjetorit të “Diellit”.

“Dielli” u botuan shkrime, informacione e komente ku demaskoheshin jo vetëm propaganda italiane për të joshur shqiptarët, por u denoncuan qëllimet dhe planet italiane në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit ku jetonin shqiptarët.

Propaganda e fashizmit duke shpërndarë harta të Shqipërisë që përfshinin edhe vendet e pushtuara nga fqinjët me kufij që shkonin në Janinë, Selanik, Manastir e Shkup, përgënjeshtrohej nga “Dielli”. Ky i fundit shprehte bindjen se, këto vende që shënuam më lart, pushtuesit nuk i kërkojnë se janë vende shqiptare dhe duhet t’i kthehen Shqipërisë, por kanë ndërmend t’i grabitin për vete, sikundër grabitnë Shqipërinë e lirë².

Në vitet e para të pushtimit të Shqipërisë, “Dielli” me shkrimet e veta, i bënte një analizë të saktë e realiste situatës përpara së cilës ndodheshin shqiptarët, për t’i orientuar drejt ata. Me të drejtë pohonte “Dielli” se “Shqiptarët edhe pse nuk e duan fashizmin s’kanë fuqi ta kundërshtojnë Italinë”. Në këtë mes luanin rolin e vet edhe një takëm shqiptarësh, që “Dielli” i quante “shpirtkalbur”, të cilët shiteshin për para, për t’i bërë varrin Shqipërisë. Nën ndikimin e këtyre njerëzve, populli shqiptar ishte i shtrënguar të vishte këmishën e zezë dhe të thërriste “rroftë” ky apo ai eksponent fashist³.

“Dielli” u kujtonte shqiptarëve se rekrutimi i tyre në ushtrinë italiane, duke i motivuar me sloganin se “Shqiptarët duhet të luftojnë për madhimin e vendit të tyre”, ishte një mashtrim i komandës italiane, qëllimi i së cilës ishte t’i çonte shqiptarët në vijën e parë të frontit të luftës, që të vriteshin për interesat e Italisë”. Dhe me të vërtetë kështu ndodhi me repartet shqiptare që u mobilizuan në frontin e luftës italo-greke, të cilët u vendosën në vijën e parë të sulmit, prandaj ato dezertuan masivisht nga fronti i luftës.

Nga ana tjetër, “Dielli” bënte të qartë se, organizmat e administratës fashiste në Shqipëri nuk përfaqësonin shqiptarët, por një “të vetëthënë qeveri shqiptare”, me të cilën “Musolini kërkonte të zbuste popullin shqiptar dhe të gënjente botën e huaj”. “Dielli” pohonte se edhe “bota e di fort bukur se sot s’ka Shqipëri, as guvernë shqiptare, por ajo është një koloni e vogël e Italisë”. Për rrjedhojë, për të gjitha sulmet që ndërmori Italia ndaj fqinjëve të Shqipërisë s’kishte faj as Shqipëria e as populli i saj⁴.

Duke vepruar në një vend të lirë “Dielli” kishte të gjitha mundësitë që në faqet e tij, të mbronte jo vetëm interesat kombëtare të shqiptarëve, por edhe t’u ndriçonte mendjen atyre shqiptarëve që ishin mashtruar nga aparencia propagandistike e fashizmit, për të zbutur frymën atdhetare të qëndresës shqiptare.

² “Italianët tallen me popullin shqiptar”, *Dielli*, Boston Mass., 1 korrik 1940.

³ *Po aty*. Në “Dielli” përmenden emrat e këtyre eksponentëve të fashizmit Tefik Mborja dhe Ettore Mutti.

⁴ “S’ka faj Shqipëria, as populli i saj”, *po aty*, , f. 2.

Në situatën fillestare të paspushtimit të Shqipërisë, politika e fqinjëve dhe e Fuqive të Mëdha, sidomos ajo e qeverisë britanike, kundrejt pavarësisë dhe integritetit territorial të Shqipërisë, u shpalos me një qëndrim të dyshimtë. Në këto rrethana, emigracioni shqiptar në Angli, SHBA dhe në shumë vende të tjera, filloi të ushtronte presion ndaj qeverive të këtyre vendeve, që ata të pranonin dhe të mbështetnin, pa mëdyshe, rimëkëmbjen e pavarësisë dhe ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë.

Në vitin 1941 dhe sidomos gjatë vitit 1942, në adresë të diplomacisë britanike dhe të qeverisë së saj, u dërguan një sërë letrash, telegramesh, peticionesh e memorandumesh ku kërkoheshin të respektoheshin parimet e Kartës së Atlantikut. Midis tyre spikaste letra e mikes së Shqipërisë E. Durham, e cila kritikonte indiferentizmin e qeverisë britanike ndaj fateve të këtij populli dhe kërkonte me forcë respektimin e pavarësisë dhe të integritetit të Shqipërisë.

Emigracioni shqiptar në Amerikë konsideroi si detyrë të dorës së parë përkrahjen e përpjekjeve për formimin dhe njohjen ndërkombëtare të një qeverie shqiptare në mërgim. Krijimi i një qeverie të tillë konsiderohej, nga shumica e politikanëve shqiptarë, si një faktor themelor juridik e politik për ruajtjen e legalitetit dhe statusit juridiko-territorial të shtetit shqiptar. Nga ana tjetër, krijimi i një qeverie të tillë do të ishte faktor organizimi e mobilizimi i shqiptarëve në luftën çlirimtare dhe do të siguronte mbrojtjen e interesave shqiptare në arenën ndërkombëtare.

Krijimin e një qeverie shqiptare në mërgim e bënte të domosdoshme edhe fakti se, vendet fqinje i kishin ruajtur qeveritë e tyre në mërgim, të cilat, jo vetëm po mbronin me efektivitet interesat e tyre kombëtare, por po kryenin veprimtari të ethshme politike e diplomatike, për realizimin e synimeve të vjetra aneksioniste ndaj Shqipërisë.

E para tentativë, për formimin e kësaj qeverie shqiptare në mërgim, u bë vetëm pak ditë pas sulmit italian kundër Greqisë, duke theksuar se ky sulm “e kishte shtuar urgjencën e çështjes”⁵. Në mënyrë të natyrshme, gjatë këtyre përpjekjeve duhej llogaritur Ahmet Zogu, mbartësi legjitim i sovranitetit të shtetit shqiptar.

Rymat e ndryshme të emigracionit, të mbështetura në motive sa kombëtare aq edhe juridike, fillimisht e vlerësuan Zogun si pikë qendrore për krijimin e qeverisë shqiptare. Me të drejtë ai shihej si “përfaqësues legjitim i shtetit shqiptar” dhe “bartësi i vetëm i vazhdimësisë së tij konstitucionale”⁶.

⁵ Foreign Office (më tej: F.O.), 371/24866. Kopje e letrës së Dervish Dumës dërguar Nolit dhe Nelo Dizdarit, kapur nga çensura britanike, 6 nëntor 1940. (Referencat arkivore sipas B. Meta në: *Tensioni greko-shqiptar (1939-1949)*).

⁶ F.O. 371/33109. Relacion i P. Dixonit mbi bisedën me Tajar Zavalanin, 3 korrik 1942.

Një qeveri me A. Zogun në krye, gjykohej edhe si garanci jo vetëm për rimëkëmbjen e pavarësisë, por edhe për paprekshmërinë e kufijve në fund të luftës.

Në lëvizjen për krijimin dhe pranimin e një qeverie shqiptare në mërgim u përfshinë jo vetëm organizatat politike të emigracionit të drejtuara nga Noli, Konica, Çekrezi, Zavalani, por edhe grupime të tjera emigrantësh. Shqiptarët që punonin në industrinë e luftës së SHBA, me anë të një memorandumit, i kërkonin C. Hullit pranimin e një qeverie shqiptare në mërgim nën kryesinë e mbretit A.Zogu⁷.

Me një mbështetje të tillë të emigracionit shqiptar, A.Zogu i kërkoi Forin Offisit britanik, në mars të vitit 1942, të njihej si kryetar shteti në mërgim, sepse pozita e tij ishte e njëllotë me atë të mbretërve të Greqisë dhe të Jugosllavisë. Kjo kërkesë edhe pse do të përsëritej në qershor të vitit 1942, nuk u pëlqye nga Forin Offisi⁸. Por me sa duket qeveria britanike në këtë kohë nuk e kishte përcaktuar qëndrimin kundrejt Shqipërisë⁹.

Veprimet e Zogut u mbështetën edhe nga Noli e Konica, dy krerët e emigracionit shqiptar, me vizitën e tyre në Departamentin e Shtetit, në nëntor të vitit 1942¹⁰. Gjatë bisedës ata argumentuan domosdoshmërinë e krijimit të qeverisë me A.Zogun në krye, si “personaliteti më i shquar shqiptar”. Noli e konsideronte rrezikun grek si faktor thelbësor që e bënte të domosdoshme njohjen e Zogut si kryetar i qeverisë shqiptare në mërgim.

Noli i shprehte C.Hullit shqetësimin se deklarata amerikane për pavarësinë e Shqipërisë, edhe pse ishte e shkëlqyer nga pikëpamja parimore, ishte e destinuar të mbetej në letër, në qoftë se nuk do të përforcohej (kjo deklaratë- M.D.) me garantimin e integritetit tokësor të Shqipërisë dhe me njohjen zyrtare të Mbretit Zog si kryetar legjitim dhe logjik i qeverisë shqiptare në mërgim, së cilës t’i garantohej edhe një vend në Konferencën e Paqes.

Në se deri në dhjetor të vitit 1942 pengesë për krijimin e një fronti unik dhe të qeverisë shqiptare në mërgim ishte kundërshtimi i politikës britanike, me vdekjen e F. Konicës, u krijua dhe një pengesë e brendshme në emigracionin shqiptar.

⁷ *United States National Archives* (më tej: *USNA*) DS.875.01/564.1/2. Memorandum i shqiptarëve që punonin në industrinë e luftës së SHBA, dërguar C.Hullit (pa datë).

⁸ F.O. 371/33110. Raporte të A.Royanit mbi bisedat me Zogun, 24 qershor dhe 4 korrik 1942.

⁹ F.O.371/33109/R4470/390/90. Shënime të Dixonit pas bisedës me T. Zavalanin, 3 korrik 1942.

¹⁰ *USNA*. DS.F.W.875.01/427. Promemorje e Nolit dhe e Konicës pas vizitës në Departamentin e Shtetit, 19 nëntor 1942.

Organizata e fuqishme “Vatra” mbeti pa krerët e saj të shquar, tek të cilët Zogu gjeti mbështetje pa kushte. Noli, tashmë, kishte refuzuar të merrte pjesë zyrtarisht në jetën politike shqiptare. “Antizogistët” apo “republikanët” e Londrës dhe të SHBA, pas këtyre ndryshimeve koniunkturale, u tërhoqën nga pozicioni i mëparshëm, kur vetëm përkohësisht kishin pranuar t’ua nënshtronin interesat e tyre politike, interesave kombëtare. Ata i përfshiu pasioni i mëparshëm i luftës kundër A.Zogut pa marrë parasysh pasojat që do të kishte ky qëndrim për çështjen shqiptare.

Megjithatë, Noli dhe Vatanët mbajtën, edhe pas kësaj situate, një qëndrim konsekuent. Është i njohur telegrami i Nolit dërguar C.Hullit pas botimit të deklaratës britanike, ku theksonte se, pikërisht për arsye të rrezikut grek dhe të ekuivokëve të deklaratës britanike, ishte e nevojshme që Shqipërisë i duheshin dhënë garancitë. Dhe një gjë e tillë bëhej duke njohur zyrtarisht një qeveri shqiptare në emigracion nën drejtimin e Mbretit Zog, me pranimin e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara dhe me garantimin e integritetit territorial të saj.

Mjaft emigrantë shqiptarë të Amerikës i shprehnin bindjen Departamentit të Shtetit se “vetëm fronti i bashkuar shqiptar nën udhëheqjen e Mbretit Zog, ishte mënyra më efektive, për të ndihmuar Shqipërinë dhe Kombet e Bashkuara”¹¹.

Lëvizja e emigracionit shqiptar, për organizimin e luftës antifashiste në Shqipëri dhe për krijimin e qeverisë shqiptare në mërgim, vazhdoi të rritej edhe pas deklaratave të Fuqive të Mëdha, në dhjetor 1942. Mbështetjen më të madhe kjo lëvizje me idenë e krijimit të një qeverie shqiptare në mërgim, e pati nga radhët e “Vatrës”, e cila kishte një traditë të gjatë në luftën kundër politikës aneksioniste greke.

Për Nolin, rreziku grek ishte faktori kryesor që e shtyu ta shihte shpëtimin e Shqipërisë në ruajtjen e trashëgimisë legale të saj, pra, në njohjen e përfaqësuesit të shtetit shqiptar, A.Zogut, ndonëse ky ishte kundërshtar politik i Nolit. Të shqetësuar për pozitën e Shqipërisë, në raport me vendet e tjera me qeveri në Londër dhe me ambasadorë në Uashington, Noli dhe Konica kishin arritur në përfundimin se, nuk mund të rrinin duarkryq me arsyetimin se “Zogu mund të konsiderohej si një autoritet që paraqiste një shpresë, se mund të pranohej nga Aleatët, si përfaqësues i vazhdimit të shtetit të pavarur shqiptar. Rrjedhimisht, rreth tij, mund të krijohet një qeveri shqiptare në mërgim e cila mund të pranohej nga qeveritë amerikane dhe britanike, gjë që do të siguronte njohjen e Shqipërisë si komb i bashkuar dhe njohjen e pavarësisë dhe tërësisë

¹¹ *Po aty*, 875.01/474. Telegram i Shaqir Bucos, Asat Hasanit, Mehmet Kinakolicit, Hysen Panaritit etj., dërguar C.Hullit, 28 dhjetor 1942.

tokësore pas luftës. Kjo do të pengonte e do të “thyente intrigat e pretendimet tokësore të qeverisë shoviniste greke e jugosllave në Londër”¹².

Nga ana tjetër, kundërshtarët e Zogut ose republikanët bënë përçapje që të krijonin një komitet kombëtar shqiptar “Komiteti i Shqipërisë së Lirë”, në vend të një qeverie, duke pranuar që ky Komitet të kishte Zogun në krye. Ky Komitet, sipas republikanëve, e linte hapur çështjen e përcaktimit të formës së regjimit pas luftës.

Për Zogun përkrahja e kësaj ideje ishte vetëvrasje. Prandaj këmbëngulte në krijimin e qeverisë legale, të cilën e vlerësonte si garanci të pavarësisë dhe të integritetit territorial të Shqipërisë¹³. Pranimi i Komitetit në vend të qeverisë, do t’u mohonte shqiptarëve të drejtat e fituara gjatë 20 vjetëve të jetës kombëtare dhe pavarësisë, do të bënte që çështja shqiptare të shqyrtohej edhe një herë nga fillimi, pa patur asnjë siguri se rezultati do të ishte në interes të Shqipërisë.

Politika e lëshimeve britanike, për të mos cenuar pretendimet territoriale greke ndaj Shqipërisë, e përçau emigracionin shqiptar, lidhur me rrugët për të mbrojtur integritetin e Shqipërisë nga pretendimet e fqinjëve. Në këtë rreth vicioz të emigracionit shqiptar, një pjesë e mirë e shqiptarëve në vendet e lira, të kryesuar nga “Vatra”, ngulnin këmbë për pranimin pa kushte të Mbretit Zog, gjë që gjeti pasqyrim në faqet e “Diellit”¹⁴.

Në këto rrethana, gjatë këtij debati, në emigracionin shqiptar u shpenzua mjaft kohë dhe energji, duke zbehur e zvarritur përpjekjet për të kundërshtuar propagandën dhe ofensivën diplomatike të qeverisë mbretërore greke në Londër dhe në Uashington.

Në verën e vitit 1944, kur fashizmi po merrte goditjet vendimtare, rreziku komunist po afrohej me shpejtësi. Ofensiva greke për aneksimin e Shqipërisë së Jugut po ashpërsohej dhe intensifikohej. Përpara këtij rreziku, shqiptarët e Amerikës të mbledhur në një miting, miratuan një rezolutë për Fuqitë e Mëdha dhe Kombet e Bashkuara¹⁵. Rezoluta kërkonte njohjen zyrtare të qeverisë shqiptare në ekzil, ashtu si kjo qeveri kishte ekzistuar para 7 prillit 1939 dhe pranimin e Shqipërisë me të drejta të plota në OKB.

“Vatra” dhe “Dielli” mbështetën me konsekuencë krijimin e një fronti të përbashkët të shqiptarëve. Prandaj, në vitet e para “Vatra” kishte mbajtur qëndrim kritik ndaj politikës britanike. Për deklaratën e Edenit, dhjetor 1942 “Dielli” kritikonte faktin se ajo “u muar nga grekët si një ftesë dhe ata

¹² Behar Shtylla, *Noli siç e kam njohur unë*, Tiranë: 1997, f. 112.

¹³ F.O.371/37 137. Kopje e letrës së Sotir Martinut drejtuar Tajar Zavalanit, 11 maj 1943.

¹⁴ Po aty. Letër e T. Zavalanit dërguar Miss Barkerit, 24 tetor 1943.

¹⁵ F.O.371/43555/R 179/71/90. Telegram dërguar A. Edenit nga Kryesia e Komitetit për Çlirimin e Shqipërisë (Christ Lepon, Petro Danushi, Christ Skurte, Ismail Emini, Angelo Peters) 9 qershor 1944.

shpejtuan të përgatitnin dasmën për copëtimin e Shqipërisë. Deklarata e zotit Eden u përhap si një sëmundje ngjitëse në të gjitha anët dhe nuk la asnjë grek gjëkund pa zënë. Këtu në Amerikë, grekomanët “epirotë” hapën kuletat dhe nisën përsëri nga avazi i vjetër, me shpresë që t’i mbushnin kokën popullit amerikan se shqiptarët janë grekë”¹⁶.

Zhvillimi i ngjarjeve politike dhe ushtarake në Shqipëri, në fund të verës së vitit 1944, me epërsinë e forcave komuniste në drejtimin e vendit, ndikoi dhe në qëndrimin e një pjese të mirë të emigracionit shqiptar. Nisur nga interesat kombëtare, duke ndërë thellë rrezikun dhe presionin grek në Shqipërinë e Jugut, “Vatra” dhe “Dielli” e mbështetën qeverinë e Enver Hoxhës, siç kishte kërkuar, më parë, krijimin e frontit të përbashkët shqiptar.

“Dielli” do të shkruante : “Lumturisht sot, Toskëria e ka një zot dhe kjo është qeveria provizore e Beratit. Edhe pse s’është njohur, ajo do të njihet. Ne prej së largu duhet të bëjmë ato që nevojiten: të kërkojmë njohjen e qeverisë provizore të Beratit dhe do të insistojmë që kësaj qeverie t’i jepet leje të dërgojë një delegacion në kryeqytetet e mëdhenj, duke nisur nga Uashingtoni”¹⁷.

Në këtë qëndrim për zhvillimet politike në Shqipëri gjetën gjuhën e përbashkët organizatat e emigracionit shqiptar në Amerikë. Organizata “Shqipëria e Lirë” dhe “Vatra”, njëra pas tjetrës, në gusht e shtator 1944, i kërkuan qeverisë amerikane të njihje qeverinë e Frontit NÇI të Shqipërisë.

Edhe Kishat Ortodokse Shqiptare të Amerikës, me anë të një telegrami drejtuar C.Hullit, i kërkonin njohjen e qeverisë së krijuar në Shqipëri. Këtë veprim e mbështeti dhe “Vatra”, me anë të presidentit të saj Vasil Pani, i cili i parashtrou Eduard Stettinusi të njëjtat kërkesa për pranimin e përfaqësuesve të qeverisë shqiptare në Kombet e Bashkuara dhe në Konferencën e Paqes si dhe frenimin e përpjekjeve greke për copëtimin e Shqipërisë dhe garantimin e integritetit e pavarësisë së saj¹⁸. Faktor kryesor që ndikoi në qëndrimin mbështetës të Nolit dhe të “Vatrës” ndaj qeverisë komuniste ka qenë synimi për ta forcuar pozitën e Shqipërisë në raport me lëvizjet dhe pretendimet greke.

Në përputhje me këtë politikë të “Vatrës” ndaj ngjarjeve në Shqipëri, “Dielli” në faqet e saj i la hapësirë të konsiderueshme propagandimit të luftës së partizanëve si dhe thirrjeve për t’i ndihmuar ato me çdo mjet. “Dielli” publikoi lajme të ndryshme për situatën në Shqipëri si në fushën politike, ekonomike dhe arsimore e kulturore, duke i bërë jehonë propagandës që bëhej edhe në Shqipëri, pa i bërë asaj pothuajse asnjë koment. Megjithatë, në faqet e

¹⁶ “Toskëria sot”, *Dielli*, 18 nëntor 1944.

¹⁷ *Po aty*.

¹⁸ *USNA*. DS.FW. 875.01/11-3044. Telegram i Vasil Panit dërguar Eduard Stettinusi, 11 dhjetor 1944.

“Diellit” gjeti pasqyrim edhe opinioni ndryshe, lidhur me reformat që nisën të zbatoheshin në Shqipëri në fushën e pronës dhe të kapitalit.

Është me interes një debat, i bërë lidhur me zhvillimin e reformës agrare, që u shpalos në programin e qeverisë. Kritika në këtë drejtim bëhej për faktin se këto reforma ekonomike ishin të parakohshme. “Le të sigurojmë lirinë e Shqipërisë më parë, pastaj reformat – thuhej në një shkrim të R.Xh. Gurrazezit, të 4 nëntorit 1944, te “Dielli”. “Le të sigurojmë qetësinë e brendshme duke mbledhur gjithë grupet ose partitë kundërshtarë rreth një guverne të fortë. Pastaj do të vijë koha që të bisedojmë edhe për bërjen e reformës agrare”¹⁹.

Duke ecur në rrugën e mbështetjes së qeverisë provizore të Shqipërisë, “Vatra” dhe “Dielli” kërkonin me insistim njohjen e saj nga Aleatët. Madje, në faqet e “Diellit” kritikoheshin ashpër kjo mosnjohje. “Ta quash këtë një padrejtësi, nuk është mjaft, duhet t’i japim emrin që meriton. Kjo është një tradhti e idealeve të Kombeve të Bashkuara. As më pak, as më shumë. Kjo tradhti duhet ndrequr sa më shpejt”²⁰.

Moto e punës së “Vatrës” dhe e “Diellit” në fund të luftës mbeti tradita e grumbullimit të ndihmave për shqiptarët e sapo dalë nga lufta. “Dielli” jepte njoftime për situatën e rëndë ekonomike në Shqipëri dhe krahas saj dhe pasqyrën e ndihmave të grumbulluara, duke i qëndruar konsekuente traditës së shqiptarët e Amerikës nuk ishin shkëputur nga hallet, shqetësimet e vuajtjet e Atdheut të tyre – Shqipërisë. Veprimtaria e “Diellit”, edhe në rrethanat komplekse të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri, ku interferonin faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, mbeti si gjithnjë në shërbim të çështjes kombëtare shqiptare.

¹⁹ “Le të sigurojmë lirinë e Shqipërisë më parë, pastaj reformat”, *Dielli*, 4 nëntor 1944.

²⁰ “Lajme nga Shqipëria”, *Po aty*, 2 dhjetor 1944.